



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____

Dt: 26.10.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L-040, duke iu referuar shkresës zyrtare të Zyrës së Prokurimit të Komunës së Gjakovës 02 nr. 400-25310 e dt: 03.04.201, me të cilën është njoftuar operatori ekonomik NNT."EKO" për ndërprerjen e kontratës nr. 093 e lidhur me dt: 19.01.2009 në mes të Komunës së Gjakovës- Zyra e Prokurimit dhe NNT "EKO", Përfundimit 01 nr. 06-25194-9/4 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 03.04.2015, si dhe Procesverbalit të Komisionit për evidentimin e kiosqeve, verifikimin e kontratave dhe pasqyrës financiare të obligimeve të operatorit ekonomik "EKO" i dt: 05.06.2015 dhe raportit final të këtij komisioni të dt: 17.06.2015, e me qëllim të krijimit të kushteve për menaxhimin e këtyre kiosqeve të cilat kanë mbetur si prona pa mbikëqyrje, me dt: 26.10.2015, e miraton këtë:

V E N D I M

- 1.** Autorizohet Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Gjakovës që të ndërmerr të gjitha veprimet për krijimin e kushteve të menaxhimit të kiosqeve, të cilat kanë mbetur pa u menaxhuar pas ndërprerjes së kontratës nr. 093 e dt: 19.01.2009, e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës –Zyra e prokurimit Publik dhe NNT "EKO" me seli në Gjakovë .
- 2.** Menaxhimi i kiosqeve duhet të bëhet me qëllim të krijimit të kushteve për mbikëqyrjen e tyre nga organet kompetente të administratës publike të Komunës së Gjakovës, duke i ndërmarr veprimet në harmoni me të dhënat dhe sugjerimet nga procesverbali i Komisionit për evidentimin e kiosqeve, verifikimin e lejeve dhe kontratave me NNT "EKO", si dhe raportit final të këtij Komisioni.
- 3.** Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik duhet ti fton shfrytëzuesit e kiosqeve të cilat më parë janë menaxhuar nga NNT "EKO" për lidhjen e kontratave të reja, në harmoni me dispozitat ligjore dhe aktet e tjera komunale me të cilat rregullohet kjo fushë.
- 4.** Drejtoria për Buxhet dhe Financa duhet të bashkëpunon me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për hartimin e raportit financiar, në të cilin do të prezantohen të dhënat për borxhin e NNT"EKO" ndaj komunës së Gjakovës, të evidentuar në bazë të obligimeve sipas kontratën nr. 093 e dt: 19.01.2009 dhe këtë raport t'ia përcjell Avokaturës Publike të Komunës së Gjakovës, për përgatitjen e padisë ndaj NNT "EKO", me kërkesëpadi për kompensimin e borxhit i cili është i krijuar për shkak të mos përmbushjes së obligimeve të kontraktuara.

5. Zbatimi i detyrimeve sipas pikës 1,2,3 të këtij vendimi do të kryhet nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ndërsa detyrimet e përcaktuara në pikën e katërt të këtij vendimi do të realizohen nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe ata të Avokaturës Publike të Komunës së Gjakovës .

6. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në funksionalizimin Zyrës për Menaxhimin e Pronës Komunale, me ç' raste me akt të veçante do të bëhet përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të zyrtarëve të kësaj zyreje.

7. Vendimi iu dorëzohet :

- Znj. Silvana Domi, drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Z. Teki Shala, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Xhelal Hoxha, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Avokaturës Publike të Komunës së Gjakovës ,
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari- Lila